

GRUPI PUNUES  
KNBE PËR  
KAPITULLIN 35



 KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG



# POZITA DHE ROLI I BASHKËSIVE FETARE DHE I KISHAVE NË PROCESIN E PAJTIMIT DHE TË NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET BEOGRADIT DHE PRISHTINËS

**Botuesi**

Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial (InTER)

**Për botuesin**

Dragiša Mijačić

**Autoret**

Aleksandra Popović  
Jelena Jorgačević Kisić

**Viti**

2020

Ky publikim është bërë në kuadër të projektit „Konventa Kombëtare rreth Bashkimit Evropian 2019/2020, Grupi Punues për Kapitullin 35” i financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, Serbi. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të Fondacionit për Shoqëri të Hapur, Serbi, Konventës Kombëtare rreth Bashkimit Evropian, e as të Institutit për Zhvillim Ekonomik Territorial.

# **Pozita dhe roli i bashkësive fetare dhe i kishave në procesin e pajtimit dhe të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës**

*Aleksandra Popović, Fondacioni Konrad Adenauer*

*Jelena Jorgačević Kisić, Forumi për religjion, media dhe kulturën e kujtesës*

**Prill 2020**



## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE</b> .....	1
<b>KISHAT DHE BASHKËSITË FETARE NË PROCESIN E PAJTIMIT</b> .....	4
Pajtimi .....	4
Demografia fetare dhe qëndrimet (jo)zyrtare.....	5
Potenciali fetar .....	7
<b>FYTYRAT E SHUMTA TË NORMALIZIMIT</b> .....	9
<b>KONTAKTET PERSONALE KONSIDEROHEN KYÇE</b> .....	11
<b>SHEMBUJT E MIRË</b> .....	12
<b>HESHTJA MEDIATIKE</b> .....	13
<b>VETËKRITIKA SI DOMOSDOSHMËRI</b> .....	14
<b>SHËNIM</b> .....	16
<b>VËREJTJET PËRMBYLLËSE</b> .....	18
<b>REKOMANDIMET</b> .....	20
<b>E bashkëngjitur 1: Lista e intervistave</b> .....	22



## **LISTA E AKRONIMEVE**

CV	Gara në të qenit viktimë (Competitive Victimhood)
BE	Bashkimi Evropian
KK	Kisha Katolike
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

*Besoj se termi pajtim është term shumë i krishterë, biblik. Nuk mendoj se i përket botës laike. Në të njëjtën kohë, unë nuk mbroj qëndrimin se pajtimi është koncept ekskluzivisht fetar ose se ai duhet të monopolizohet nga Kisha. Por mendoj se do të na humbiste thellësia e tij nëse nuk do ta konsideronim pajtimin në rrënjët e tona”<sup>1</sup>*

## **HYRJE**

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës\*<sup>2</sup> (2008), akterët ndërkombëtarë po përpiqen t'i stabilizojnë marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, dhe po bëhen pjesë e përditshme e kontekstit politik dhe shoqëror. Me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, fillon “Dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës”, rezultati pozitiv i të cilit pritet nga të tre palët – Brukseli, Beogradi, dhe Prishtina, ndërsa qëllimi i përbashkët duhet të jetë normalizimi i marrëdhënieve. Me atë rast, në prill të vitit 2013 në Bruksel, përfaqësuesit e Beogradit dhe të Prishtinës i vunë inicialet në „Marrëveshjen e parë mbi parimet e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës” - marrëveshja „e parë” e Brukselit, me parimet e së cilës vendosen kufijtë e normalizimit.

Parimet dhe qëllimet e përmendura duhet të realizohen përmes dialogut politik të ndërmjetësuar për disa pika në marrëveshjen e parë të Brukselit, e të cilat përfaqësojnë fushat e negociatave. Rrjedha e normalizimit të marrëdhënieve, procesi i arritjes së marrëveshjes ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, nga organizatat e shoqërisë civile zakonisht karakterizohen si politikisht jo transparente dhe jo-gjithëpërfshirëse nga aspekti shoqëror.

Për shembull, në publikimin „Raport mbi ndikimin e angazhimit të BE-së në ndërmjetësimin dhe nisimat e dialogut të nivelit lokal në Ballkanin Perëndimor”, Plänitz dhe Stojanović Gajić shkruajnë se ndërmjetësimi i BE-së pa përfshirjen e duhur të aktorëve vendorë vetëm se i riorienton shkaqet e konfliktit nga nivelin makro në nivelin mikro, dhe se BE-ja duhet të mbështesë përfshirjen, mes tjerash, të shoqërisë civile lokale, të shërbyesve civilë dhe aktorët politikë – të atyre që do ta zbatojnë dhe monitorojnë ndërmjetësimin dhe përpjekjet në dialog – „ose përmes *track II* ose *track III*<sup>3</sup> të dialogut si faktor kryesor për promovimin e paqes së qëndrueshme dhe të vazhdueshme”<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup> Charity Majiza, Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Kishave të Afrikës Jugore (South African Council of Churches)

<sup>2</sup> „Ky përcaktim është pa prejjudikuar qëndrimet mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KSKB dhe Opinionin Këshillëdhënës të GJND mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës“.

Për nevojat e këtij teksti shfrytëzohet, pas këtij citati, termi „Kosovë“, si term i përgjithshëm për Kosovë dhe Metohi.

<sup>3</sup> Fjala është për dialogët që zhvillohen, në mënyrë jozyrtare, jo në kanale shtetërore, me të cilat, megjithatë, i kontribuohet zgjidhjes përkatësisht rregullimit të problematikave të caktuara. Ky lloj diplomacie në nivel 2. Track II zhvillohet ndërmjet individëve me ndikim, aktorëve dhe organizatave joqeveritare, ndërsa në nivelin 3, përkatësisht Track III – përmes rekomandimeve dhe qëndrimeve nga konferencat, komunikatat publike, lloje të ndryshme të takimeve dhe aktiviteteve të bisedave.

<sup>4</sup> Plänitz, Erik & Gajic, Sonja. (2017). Report on impact of EU engagement on mediation and local level dialogue initiatives in Western Balkans, f. 9. 10.13140/RG.2.2.27453.56806.



As Marrëveshja e Brukselit, e as dokumentet përkatëse, e jo rrallëherë edhe sektori joqeveritar nuk i përmendin kishat dhe komunitetet fetare si aktorë shoqërorë ose faktorë të pajtimit në shoqërinë e pas konfliktit të Kosovës.

Siç ishte konceptuar fillimisht, diplomacia e ashtuquajtur *track III* përfshin pjesëmarrjen e atyre aktorëve që janë të rëndësishëm për komunitetin, të prekur thellësisht nga dhuna dhe konflikti, siç janë udhëheqësit fetarë<sup>5</sup>. Ekziston një ndërgjegjësimit në rritje i rëndësisë së fesë në çështjet e diplomacisë, dhe në *track II*, ku hapen mundësi të reja për komunikim, kur ato zyrtare janë shumë të vogla, d.m.th., ku dialogu zyrtar është ndalur ose nuk ekziston<sup>6</sup>.

Shoqëria kosovare është e ndarë në mënyra të ndryshme, përgjatë linjave politike, etnike, sociale, administrative dhe fetare. Në raportin „*Kohezioni Social në Kosovë: Shqyrtimi i kontekstit dhe pikave hyrëse*”, që doli nga një punëtori me aktorët relevantë, thuhet se “komunitetet jetojnë pranë njëra tjetrës, por jo së bashku”<sup>7</sup>, dhe se „gjenerata pas konfliktit në Kosovë nxitet nga narrativat e konfliktit që zakonisht paraqiten si të vërteta absolute, dhe me ndërveprim të kufizuar me gjeneratën origjinale nga konflikti, një ndërveprim që mund të ofrojë një vërtetim empirik për të sfiduar narrativat mbizotëruese, ndërsa është e cenueshme nga paragjykimet e trashëguara”<sup>8</sup>.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që t’i identifikojë “instrumentet” me të cilat shoqëria e Beogradit dhe e Prishtinës, të përcaktuar me të njëjtin qëllim të një të ardhme paqësore dhe të prosperuar evropiane, duhet të marrin parasysh rolin dhe pozitën e kishave dhe bashkësive fetare në procesin e pajtimit dhe të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, si dhe t’i njohim resurset (e pashfrytëzuara sa duhet) për paqe. Pyetjet nga të cilat jemi udhëhequr gjatë mbledhjes së të dhënave përmes intervistave, si dhe analiza e përvojave ekzistuese në vendet e tjera, janë si vijon:

1. Cili është potenciali i kishave dhe i bashkësive fetare në shoqërinë kosovare sot, kur bëhet fjalë për pajtimin? Si aktualizohet ai sot, ku janë problemet, dhe ku është hapësira më e madhe për veprim? Si vlerësohet puna e kishës dhe e bashkësive fetare deri tani në shoqëritë sa i përket bashkëjetesës së serbëve dhe shqiptarëve? Cilat hapa të mëtejshëm janë të nevojshëm?
2. Çfarë do të thoshte normalizim i marrëdhënieve për përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe dhe Kishës Katolike në Kosovë dhe Beograd? Si e shohin ata rolin e tyre në procesin e normalizimit? Çfarë mund të bëjnë më shumë ata? Për çfarë mbështetje do të kishin ata nevojë? Cili është bashkëpunimi aktual?
3. Cilët udhëzues dhe praktika të mira mund të identifikohen dhe aplikohen, duke pasur parasysh kontekstin politik dhe shoqëror?

<sup>5</sup> Diamond dhe McDonald (1993), ata të cilët e krijuan konceptin e diplomacisë multi-track, si njërin nga nëntë fushat kryesore (track) e kanë përmendur „religjioni ose paqe bërja përmes fesë në aksion“.

<sup>6</sup> Petersen, Rondey, L. (2015). Religion and multi-track diplomacy, str. 229. 10.1017/CBO9781316106693.015.

<sup>7</sup> UNDP në Kosovë dhe Akademia Folke Bernadot. (2019). Kohezioni Social në Kosovë: Shqyrtimi i kontekstit dhe pikave hyrëse, f. 10.

<sup>8</sup> Po aty, f. 11-12.

Hulumtimi përfshin një analizë të shkurtër të rolit të kishave dhe bashkësive fetare në një shoqëri pas konfliktit, në proceset e pajtimit dhe të normalizimit. Pjesa kryesore e hulumtimit bazohet në intervistat me përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe (KOS) dhe Kishës Katolike (KK) në Serbi dhe Kosovë, si dhe intervista ekspertësh, të cilat përfshinin bashkëbisedues nga akademia, sektori i OJQ-ve dhe mediat. Përmbajtjet e intervistave i cekim përmes institucioneve, kishave dhe bashkësive fetare, përkatësisht institucioneve që janë intervistuar.

Megjithëse plani fillestar ishte të bëheshin intervista drejtpërdrejt me bashkëbiseduesit, për shkak të pandemisë së virusit Covid-19, ato u realizuan me shkrim. Fatkeqësisht, anëtarët e bashkësive islame në Kosovë dhe Serbi nuk ishin në gjendje të marrin pjesë, dhe në fund ata nuk mund as të përfshihen në këtë punë kërkimore.

Mostra bazë përfshinte 15 intervista:

- Katër përfaqësues të KOS-it (nga Dioqeza e Rashkës-Prizrenit dhe Arqipeshkëvisë së Beogradit-Karlovcit),
- Përfaqësues të Kishës Katolike në Kosovë dhe tre përfaqësues të Kishës Katolike në Serbi (nga Arqipeshkëvia e Beogradit dhe Ipeshkëvia e Suboticës),
- Tre profesorë universiteti,
- Dy përfaqësues të mediave,
- Një përfaqësues i sektorit joqeveritar, dhe
- Një përfaqësues i një organizate ndërkombëtare.

Hulumtimi nuk pretendon të sigurojë një përmbledhje gjithëpërfshirëse të kësaj teme, por të ofrojë rekomandime bazuar në intervistat me aktorë përkatës të kishave dhe të shoqërive, me qëllim që proceset e pajtimit dhe të normalizimit të bëhen sa më gjithanshme, gjithëpërfshirëse dhe efikase.

## **KISHAT DHE BASHKËSITË FETARE NË PROCESIN E PAJTIMIT**

### **Pajtimi**

Diplomacia tradicionale e paqes ka instrumente të kufizuara për qasje gjithëpërfshirëse, të gjerë për zgjidhjen e çështjeve të së kaluarës. Pajtimi kërkon rrumbullakësim. Ky është edhe përparësia e tij ndaj instituteve juridike të marrëdhënieve pas konfliktit. Pajtimi nuk është harmonizimi i konflikteve, por një proces afatgjatë, ku realiteti i konfliktit transferohet në perspektivën e së ardhmes. Fuqia e pajtimit ndërmjet dy palëve është në të kuptuarit se asnjëra palë, pa tjetrën, nuk mund të bëjë ndërtimin e shoqërisë së vet<sup>9</sup>.

Në kulturën e krishterë, pajtimi jeton në vetëdijen fetare. Kishat dhe bashkësitë fetare, duke theksuar vlerat e krishtera, i zvogëlojnë motivet për konflikt dhe rrisin mundësitë për pajtim, pa amnistuar krimin (elët), dhe pa diskredituar moralin e pajtimit. Domethënë, pajtimi është në mënyrë burimore i lidhur me kontekstin fetar, por ai prej kohësh është parë si pjesë e diskursit politik dhe historik<sup>10</sup>. Mesazhet e krishtera të faljes, dhe, në përgjithësi, supozimet e traditës Abrahamike (Judaizmi, Islami, Krishterimi), se të gjithë njerëzit janë të barabartë para Zotit, mund të jenë mjet i vlefshëm kur bëhet fjalë për trajtimin e emocioneve ndaj tjetrit, të pikëllimit, fajit ose nevojës për hakmarrje. Bashkësitë fetare janë të lidhura me kujtesën dhe identitetin<sup>11</sup>. Në këtë kostelacion të ndërlikuar, aktorët fetarë mund të luajnë rol të rëndësishëm si ata që janë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të narracioneve dhe botëkuptimeve të përbashkëta mbi botën<sup>12</sup>. Vlen të theksohet se kishat dhe bashkësitë fetare vetë i mbajnë ndarjet në shoqëri, sidoqoftë, megjithëse ky është problemi më i madh, në të njëjtën kohë kjo është hapësira më e madhe për ndryshime<sup>13</sup>. Në një shoqëri pas konfliktit, distancimi i ndërsjellë i individëve, tjetërsimi i tyre janë reagime natyrore ndaj lëndimit, duke theksuar nevojën për mbrojtje. Roli social-integrues i kishave dhe i bashkësive fetare në shoqëritë e pas konfliktit pasqyrohet, siç u përmend, në përvojën e menjëhershme të vlerave karakteristike të fesë, me të cilat tejkalohej dhimbja personale e individëve.

Në procesin e pajtimit, është thelbësore që institucionet fetare të mbrojnë barazinë dhe përgjegjësinë midis njerëzve. Të dy palët në proces, agresori – për veprimet në të kaluarën dhe të ardhmen, kur ai do të kërkojë falje, dhe viktimat – duke përjetuar trauma dhe duke kapërcyer dhimbjen, duke u bërë gati për të pranuar kërkim-faljen në të ardhmen. Dimensioni personal i

<sup>9</sup> Sommerfeldt, Atle. (2000). *Nema prečice do pomirenja*, f. 234–235, u: Teško pomirenje, urednik Enver Đuliman, izd. Helsinški komitet Norveške, Norveška crkvena pomoć, Oslo – Sarajevo.

<sup>10</sup> Schliesser, Christine. (2018). *From “a Theology of Genocide” to a “Theology of Reconciliation”?* *On the Role of Christian Churches in the Nexus of Religion and Genocide in Rwanda*, str. 8. Religions. 9. 34. 10.3390/rel9020034.

<sup>11</sup> „Lufta me të kaluarën dhe me faljen, problemet e (ri)kujtesës pas kohëve të shkatërrimit, përzihen me problemet e kujtesës dhe besueshmërinë e të kaluarës dhe me faljen dhe me problemet e fajësisë dhe pajtimit me të kaluarën“, Petersen, Rodney L. (2015). *Religion and multi-track diplomacy*, f. 231, 10.1017/CBO9781316106693.015.

<sup>12</sup> Ibid, str. 232.

<sup>13</sup> Van der Merwe, Hugo. (2003). *The Role of the Church in Promoting Reconciliation in Post-TRC South Africa*, str. 276, u *Religion and Reconciliation in South Africa. Voices of Religious Leaders*, urednici Audrey R. Chapman i Bernard Spong. Templeton Foundation Press. Filadelfija i London. f. 269-281.

pajtimit të secilit individ e çliron shoqërinë nga faji kolektiv. Duke u mbështetur në virtyte të krishtera, kishat dhe bashkësitë fetare e konfirmojnë veten si aktorë që mund të kontribuojnë për paqen dhe zgjidhjen e konflikteve.

Sigurisht, natyra e fesë është e tillë që ajo i përmban edhe ato elemente që mund ta rrisin konfliktin, por edhe ta transformojnë atë, dhe nuk duhet ta mohojmë dhe të harrojmë se institucionet fetare jo rrallëherë kanë “provokuar demonët e dhunës”<sup>14</sup>. Sidoqoftë, këmbëngulja e vazhdueshme për rolin e tyre në konflikt i ka hedhur prapa krahëve edhe veprimet e karakterit paqeruajtës, si dhe potencialin për pajtim, andaj në këtë hulumtim ne përqendrohemi në këtë tjetrën.

### Demografia fetare dhe qëndrimet (jo)zyrtare

Nuk ka të dhëna të sakta për demografinë fetare në Kosovë. Regjistrimi i vitit 2011 nuk është relevant, të paktën kur bëhet fjalë për të krishterët ortodoksë, si për shkak se nuk u mbajt në pjesën veriore, e edhe për shkak të bojkotimit nga komuniteti serb në pjesën jugore. Të dhënat nga ai regjistrim tregojnë se 95.6% e popullsisë së Kosovës deklarohen si myslimanë, 2.2% si katolikë romanë dhe 1.4% janë besimtarë të KOS-it<sup>15</sup>. Sipas të dhënave të SMRE-së (*Metadatabazës Zvicerane të Përkatësisë Fetare në Evropë*), përqindja e qytetarëve të besimit islam (shumica janë myslimanë suni) është 88.8, të krishterët ortodoksë 6.8%, ndërsa katolikë 1.7% (2015)<sup>16</sup>. Edhe pse, gjykuar sipas numrave, Kosova është një nga shoqëritë më fetare në botë, për shumicën e myslimanëve të Kosovës, origjina etnike shqiptare është më e rëndësishme sesa identiteti fetar, kështu që shoqëria kosovare përshkruhet si sekulare. Kur bëhet fjalë për KOS-in, ajo është me rëndësi të madhe për serbët në Kosovë, madje edhe për ata që nuk janë besimtarë. Një studim i vitit 2014 nga Instituti RIINVEST ka treguar se qytetarët e Kosovës kanë dukshëm më shumë besim në institucionet fetare sesa në qeveri apo partitë politike<sup>17</sup>. Kur bëhet fjalë për KOS-in, çdo vit, në anketat e opinionit publik, ajo është në vendin e parë ose të dytë si institucioni me më së shumti besim.

Kisha Ortodokse Serbe, në komunikatat e këshillit dhe sinodit, e ka deklaruar vazhdimisht qëndrimin e saj për çështjen e Kosovës. Në komunikatat e këshillit vitet e kaluara, dinjitarët e kishës kanë kërkuar që të përzënëve dhe të zhvendosurve t’u lejohet kthimi dhe mbijetesa në Kosovë, kanë shkruar për vuajtjet e popullit serb, shkatërrimin dhe përdhosjen e objekteve të shenjta dhe shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë. Disa herë në komunikatën e

<sup>14</sup> Stålssett, Gunnar. (2000). *Pomirenje – ekumenske perspektive*, str. 251, u: Teško pomirenje, urednik Enver Đuliman, izd. Helsinški komitet Norveške, Norveška crkvena pomoć, Oslo – Sarajevo.

<sup>15</sup> Vlerësohet se numri i besimtarëve të KOS-it është rreth 120.000 ose 6.3%. Shih: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2019/01/Kosovo-3.pdf> (e parë më 20. 2. 2020). Përveç kësaj numri i ortodoksëve është më i vogël se sa që është, njëra nga vërejtjet ishte se regjistruerit në disa raste, pa pyetje, e kanë shkruar „islam“, Shih: Perry, Maro (25. 6. 2015). Puls i rigjallërues religjioz i Kosovës. K2.0. Shih: <https://kosovotwopointzero.com/sr/kosovos-resurgent-religious-pulse/> (e parë më 27. 2. 2020).

<sup>16</sup> Mbi demografinë fetare në Kosovë (2006-2015), shih: [https://www.smredata.ch/en/data\\_exploring/region\\_cockpit#/mode/dataset\\_comparison/region/-99/period/2010/presentation/table](https://www.smredata.ch/en/data_exploring/region_cockpit#/mode/dataset_comparison/region/-99/period/2010/presentation/table) (e parë më 21. 2. 2020).

<sup>17</sup> Perry, Maro (25. 6. 2015). Puls i rigjallërues religjioz i Kosovës. K2.0. Shih <https://kosovotwopointzero.com/sr/kosovos-resurgent-religious-pulse/> (e parë më 27. 2. 2020).

këshillit është shprehur mospajtimi me, siç u tha në vitin 2013, „njohje direkte ose indirekte” e shtetësisë së Kosovës jashtë Serbisë, duke e quajtur atë hapësirë që prej kohësh është bërë „simbol i ndarjes, konfliktit dhe vuajtjes”.

Më në fund, në komunikatën e vitit 2013 gjendet edhe, tani për tani, i vetmi informacion për bashkëjetesën e serbëve dhe shqiptarëve: „Një nga ato pak pika të ndritshme në të është jeta dhe puna e Seminarit të rindërtuar Teologjik të Shenjtorëve Kirilit dhe Metodit në Prizren, qytetarët e të cilit, sot në shumicën dërrmuese të nacionalitetit shqiptar dhe të fesë myslimane, mundësojnë funksionimin e papenguar të këtij institucioni të rëndësishëm të Kishës Ortodokse dhe të popullit serb. Një marrëdhënie e tillë meriton respektin dhe mirënjohjen tonë”.

Përfaqësuesi i KOS-it (Dioqeza e Rashkës - Prizrenit) në një intervistë thekson se qëndrimi i KOS-it kundër njohjes së Kosovës si shtet *de facto* etnikisht të pastër shqiptar, në të cilin serbët janë të diskriminuar që 20 vjet dhe qëndrimi kundër ndarjes etnike dhe territoriale të Kosovës dhe Metohisë, nuk është i motivuar nga arsye politike apo nga mitet, por nga brenga e Kishës për mbetjen dhe mbijetesën e popullit dhe të tempujve tanë, sepse në të dyja rastet jeta e klerit, e murgjëve dhe e besimtarëve do të rrezikohet seriozisht. „Kisha e mbështet dialogun, por, para së gjithash, për normalizimin e jetës, promovimin e të drejtave dhe respektimin e ligjit, si bazë e nevojshme mbi të cilën mund të bisedohet për zgjidhje të tjera, të cilat, para së gjithash, duhet të jenë në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sigurisë së tyre dhe ruajtjes së trashëgimisë tonë shpirtërore dhe kulturore” (Intervista nr. 1).

Deri më sot, Kisha Katolike dhe Vatikani nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Nga ana tjetër, ipeshkvi i Kishës Katolike në Kosovë thekson se të gjithë, si qytetarë të Kosovës, e njohin Kosovën si shtet, „ne i njohim ortodoksët si vëllezërit tanë në besim dhe ne i njohim myslimanët si vëllezërit tanë në gjak. Ne angazhohemi për të drejtat e të gjithëve, në shtetin e ri ne përpiqemi ta kthejmë shikimin drejt një të ardhme të përbashkët, sepse jemi të bindur se nuk mund të lejojmë që e kaluara ta shkatërrojë të ardhmen tonë” (Intervista nr. 2). Për më tepër, ai thekson se serbët në Kosovë duhet ta kuptojnë se nevojat shoqërore, sociale, politike dhe juridike mund të realizohet vetëm sipas përbërjes së re të shoqërisë në Kosovë, njësoj siç është detyrë e shumicës shqiptare që t’ua mundësojë të drejtat serbëve dhe realizimin e papenguar të atyre të drejtave. Një përgjigje e ngjashme u mor edhe nga një përfaqësues tjetër i Kishës Katolike (Intervista nr. 3), në atë që themeli për njohjen e Kosovës bazohet në interpretimin e mësimave të Kishës që mëson dashurinë ndaj të vërtetës, pranimin e tjetrit dhe të ndryshmit, duke u distancuar nga çdo shovinizëm fetar ose kombëtar, por edhe duke respektuar vullnetin e atyre që nuk duan të jenë me ne.

KOS-i e kundërshtoi ashpër hyrjen e Kosovës në UNESCO, përfaqësuesit e Kishës Katolike në Kosovë e mbështetën pranimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Megjithatë, të gjithë bashkëbiseduesit e shprehin, përveç kësaj, gatishmërinë për të ndërtuar marrëdhënie me tjetrin.

## Potenciali fetar

Vetë procesin e pajtimit, të anketuarit e përshkruajnë si të kushtëzuar në masë të konsiderueshme nga vullneti politik (i diskutueshëm)<sup>18</sup>, si një mosmarrëveshje — siç dëshmon Evropa e pasluftës — një proces ky jashtëzakonisht i ndërlikuar dhe kompleks. Prandaj, potenciali i kishave dhe i bashkësive fetare shihet si i kufizuar dhe i kushtëzuar nga vendimet e elitave politike, si ata që kanë më shumë pushtet për të ndikuar në lëvizjet shoqërore. Sidoqoftë, ndonëse nuk është vendimtar, ky potencial — i cili mund të orientohet në dy drejtime përkatësisht të përdoret për „të mirë”, i orientuar drejt paqes, e që mund, përkundrazi, të provokojë konflikte („Ne kemi pasur mundësinë të shohim si ndikimet pozitive, ashtu edhe ato negative të prijësve fetarë në vitet e kaluara”; „problemi është se ata kanë qenë pjesë e konfliktit”; „fjala e njerëzve në krye të bashkësive fetare do të kontribuonte shumë për pajtimin dhe vetë bisedës”) — vlerësohet si domethënëse dhe shumë e rëndësishme kur bëhet fjalë për afrimin e bashkësive etnike, uljen e tensioneve, ndryshimin e perceptimeve për tjetrin, si dhe ndërtimin e besimit, të cilat janë të gjithë elementët padyshim të rëndësishëm për ndërtimin e kohezionit shoqëror në një shoqëri të (pas) konfliktit. Përmendet edhe rëndësia e faktorit fetar në shoqëritë lokale, si për shkakun se kishat dhe bashkësitë fetare janë një nga „konstantet e rralla në Ballkanin e trazuar?”, ashtu edhe për shkak të vuajtjes së përjetuar, e që për kapërcimin dhe shërimin e së cilës, elementi fetar ka qenë i rëndësishëm.

Njëri nga bashkëbiseduesit beson se kishat dhe bashkësitë fetare, përkatësisht udhëheqjet e tyre, kanë potencial për ndryshim pozitiv, veçanërisht sepse ato përfaqësojnë një nga katër faktorët kryesorë që kanë ndikim në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, përveç politikës, mediave dhe sistemit arsimor (Intervista nr. 5 ).

Kur bëhet fjalë për perceptimin e këtij potenciali në publik, shumë të anketuar konsiderojnë se rëndësia e udhëheqësve fetarë në publik mbivlerësohet ose nënvlerësohet, dhe më rrallë shikohet në mënyrë objektive, në kufijtë e kontributeve të mundshme dhe reale për pajtimin. Si aktualizohet ai sot në Kosovë?

Në mesin e të anketuarve nga qarqet e ekspertëve, si dhe përfaqësuesit e KOS-i dhe të Kishës Katolike, mbizotëron pikëpamja se, duke pasur parasysh rrethanat aktuale, roli i tyre i pozitiv i deritanishëm ishte kryesisht për të promovuar bashkëjetesën dhe pajtimin, ndikojnë në keq (mirëkuptimin) ndëretnik, e ruajnë paqen dhe i parandalojnë ndarjet shtesë dhe ashpërsimin e tensioneve. Të anketuarit e kombësisë serbe e theksojnë veçanërisht kujdesin dhe mbështetjen

<sup>18</sup> Në publikimin e UNDP-së I FBT (2019), f. 2, si pika kontestuese të shoqërisë në Kosovë \* përmendet se janë arsimit dhe mungesa e vullnetit politik. Ndërmjet tjerash, Grupi Punues Ndërmjetror për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin, nuk ka pasur sukses në synimin e tij të proklamuar, ndërsa shumë kritika i drejtohen, e vitin e kaluar ishte edhe, Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. Donika Emini dhe Isidora Stakić në tekstin “Beogradi dhe Prishtina: të humbur në normalizim?” vijnë në përfundimin se narrativa e përfaqësuesve politik drejtuar bashkësisë ndërkombëtare — në të cilën shprehet gatishmëria për kompromis dhe kujdes ndaj qytetarëve — është krejtësisht tjetër nga narrativa vendore e cila është nacionaliste dhe identitare. „E cila e portretizon njëri palë si fitimtare ose si viktimë „e armikut tjetër“. Shih: <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%205%20Belgrade%20and%20Pristina.pdf>

e Dioqezës së Rashkës-Prizrenit ndaj besimtarëve të tyre, por edhe qetësimin e situatës, mes tjerash, edhe përmes “komunikatave që janë të matura, që thirren në Kushtetutë dhe ligje, pa e fyer askënd” (Intervista nr. 4). „Bashkëpunimi i mirë i bashkësive fetare me institucionet lokale dhe pjesëmarrja e prijësve fetarë në këshillat lokale të sigurisë dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me vetëqeverisjet lokale, jo në pak raste, kanë parandaluar përshkallëzimin e problemeve ndëretnike” (Intervista nr. 6).

Po punohet, konkretisht, edhe në parandalimin e incidenteve ndëretnike. Siç u theksua, kishat dhe komunitetet fetare i shfrytëzojnë kanalet institucionale të komunikimit përmes, le të themi, Këshillit Zbatues dhe Mbikëqyrës të Zonave të Veçanta të Mbrojtura, me qëllim që të nxjerrin në pah problemet para liderëve politikë, por edhe para bashkësisë ndërkombëtare (Intervista nr. 6).



## **FYTYRAT E SHUMTA TË NORMALIZIMIT**

Normalizimi për të anketuarit, përfaqësuesit e KOS-it dhe të Kishës Katolike në Kosovë, e madje edhe të Kishës Katolike në Serbi, nuk ka të njëjtin kuptim.

Bashkëbiseduesit nga Dioqeza e Rashkës-Prizrenit deklarojnë se, pa hyrë në çështjen e karakterit politik të normalizimit, ai për ta përfaqëson jetë të sigurt dhe dinjitoze të klerit, të murgjëve dhe besimtarëve, mbrojtje adekuate institucionale të tempujve të shenjtë, sundim i ligjit dhe respektim i të drejtave të të gjithë qytetarëve. Disa bashkëbisedues nga sektori joqeveritar theksojnë se sa e vështirë është të flitet për pajtimin kur nuk ka respektim të të drejtave të njeriut.

Në mënyrë që të ketë përparim, është e nevojshme të përmbushen këto kushte themelore për punën sa i përket pajtimit. Përkatësisht, KOS-i shpesh ka problem sa i përket qasjes në pronën e vet, para së gjithash, në komunën e Deçanit, përkundër vendimit të gjykatës me të cilën prona iu kthye Manastirit të Deçanit, manastiri nuk mund të hyjë në posedim sepse komuna e pamundëson këtë. Po ashtu, kontestohet liria e lëvizjes për klerin e KOS-it. „Shumë kisha të shkatërruara në Kosovë ende nuk janë rindërtuar; në një numër të madh të rasteve, përfaqësuesve të KOS-it dhe të serbëve nuk u lejohet qasja në varreza, të cilat janë shkatërruar dhe thyer “(Intervista nr.9).

Në fund, përfaqësuesi i Dioqezës së Rashkës-Prizrenit nuk e sheh gatishmërinë e shoqërisë shqiptare për t’i pranuar serbët si një popull që është autokton në këtë trevë dhe i cili e ka kulturën dhe anën shpirtërore të vet (Intervista nr. 1).

Përfaqësuesit e KOS-it dhe disa përfaqësues të sektorit joqeveritar theksojnë se bashkësitë fetare shqiptare kanë shumë më pak ndikim sesa ka të KOS-i në mesin e serbëve, dhe nuk mund të mobilizojnë në mënyrë të barabartë marrëdhëniet, gjersa, nga ana tjetër, problematizohet besimi i bashkësive të tjera fetare ndaj KOS-it, ose besimtarëve të saj, për shkak se ajo identifikohet me shtetin serb. Përfaqësuesi i KOS-it konsideron se bashkësitë fetare shqiptare “nuk janë të gatshme të flasin më hapur” në mbrojtje të të drejtave të KOS-it.

Për përfaqësuesin e lartë të Kishës Katolike në Kosovë, që normalizimi të nënkuptojë pajtimin historik ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, pa të cilin ai do të ishte vetëm deklarativ, shtyrja e mospajtimeve dhe konservimi i urrejtjes në afat të gjatë ose të shkurtër, do të ishte mashtrim i madh të mendosh se është e mundur të ndërtohet të ardhme paralele ku njëra do të ishte e përshtatshme për serbët, ndërsa tjetra për shqiptarët: “Prandaj, për ne, pajtimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve do të nënkuptonte njohje të ndërsjellë, duke garantuar perspektivën fetare, kulturore dhe jetësore të shqiptarëve në Serbi dhe të serbëve në Kosovë, dhe duke e bërë të



mundur komunikimin e pa penguar ndërmjet njerëzve, shkëmbimin e ideve dhe të mallrave” (Intervista nr.2).

Në fund, Dioqeza e Rashkës-Prizrenit thekson se ata bëjnë thirrje për pajtim, se duan të ndërtojnë bashkëpunim, se pikëpamjet e tyre janë të motivuara nga mbijetesa „e popullit dhe e vendeve të shenjta”, duke theksuar se KOS-i është në pozitën pakrahasueshëm më të vështirë, por mbetet e hapur për çdo propozim konstruktiv. Më tej, përfaqësuesit e Kishës Katolike në Kosovë e shohin kishën e tyre në “rolin pasiv të një ure”, sepse me ortodoksët janë „si vëllezër në besim” ndërsa me myslimanët janë „si vëllezër në gjak”, ndërsa roli aktiv u takon atyre që duan ta shfrytëzojnë ose jo këtë urë. Të gjithë përfaqësuesit e Kishës Katolike (Intervista nr. 2; Intervista nr. 3; Intervista nr. 11; Intervista nr. 13) veprimtarinë e tyre e vlerësojnë si shumë të përqendruar në dialog, përbashkësi dhe pajtim.

KOS-it i zihet për të madhe mospranimi i së vërtetës (Intervista nr. 2; Intervista nr. 3), dhe koncentrimi më i madh në “gurë ose kocka historike, të ndonjë perandori, mbreti ose kontributet e tyre të lëna si trashëgimi” (Intervista nr. 2) sesa të punojnë për besim dhe bashkëjetesë. Bashkësisë islame i drejtohet kritika se i është kthyer ekskluzivisht vetvetes, duke shpërfillur problemet dhe realitetin, në vend se të „kujdeset për besimtarët e saj që të mos kultivojnë urrejtje ndaj të tjerëve dhe të përpiqen më aktivisht për pajtim” (Intervista nr. 2).

Theksohet se ekziston edhe më tej pikëpamja tejet jo pajtuese lidhur me dhënien e meshës në lokalitetin arkeologjik të tempullit të Shën Nikollës në Novobërdë.

## **KONTAKTET PERSONALE KONSIDEROHEN KYÇE**

Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet udhëheqësve fetarë në Kosovë shpesh përshkruhen si „korrekte”, „pa grindje të mëdha”, të mira, madje edhe të përzemërta, ndërsa kontaktet e përfaqësuesve të kishave dhjetë bashkësive fetare me besimtarët e konfesioneve dhe feve të tjera, shumica e të anketuarve i vlerësojnë si të rralla.

Prijësit fetarë takohen – ekziston një trup i përhershëm punues që i mbledh rregullisht, e për të cilën gjë kryekëput nuk janë të informuar qytetarët nga Serbia dhe jashtë vendit, që është gjithashtu një tregues i rëndësishëm i mungesës së *vëmendjes publike*. Edhe vetë përfaqësuesit theksojnë se ata takohen rregullisht që njëzet vjet dhe se në komunikatat e tyre publike nuk ka kurrfarë akuzash apo urrejtje.

„Këtu flasim sinqerisht, hapur dhe qartë për situatën tonë, ndonëse nuk pajtohemi për shumë gjëra” (Intervista nr. 2).

„Me të vërtetë është mirë që nuk kemi pasur tekste ose deklarata negative nga përfaqësuesit e një bashkësie fetare ndaj një tjetre që gati 20 vjet, dhe se takimet kanë vazhduar pothuajse vazhdimisht” (Intervista nr. 1).

Megjithatë, për disa ekspertë duket se ky dialog nuk ka zbritur nga niveli i lartë. Si një nga përjashtimet, ata përmendin Manastirin e Deçanit, i cili vizitohet si nga shqiptarët, ashtu edhe nga serbët, dhe abatin Sava Janjic. Përmes shumë përgjigjeve, kryesisht në intervistat e ekspertëve, nxirret rëndësia e kontaktit personal si ai që, me gjithë vështirësitë, di të mbizotërojë në lidhje me plogështinë apo edhe me hezitimin e strukturave kishtare-fetare.

“Edhe tek udhëheqësit fetarë, si edhe tek akademikët, profesorët dhe njerëzit në institucione të tjera, në fund të fundit është çështje e integritetit personal, dhe ajo se sa një individ është i gatshëm të shkojë kundër ndonjë diskursi të pranuar gjerësisht” (Intervista nr. 4).

## **SHEMBUJT E MIRË**

Disa të anketuar përmendën shembuj konkretë që mendonin se mund të shërbejnë si model për të dyja komunitetet. Ne po i përmendim disa prej tyre, si për shkak të rëndësisë së shembullit, ashtu edhe për shkak të perceptimit të të anketuarve lidhur me rëndësinë e tij.

Gjatë kohës së luftës, në vitin 1999, Manastiri i Deçanit u kishte ndihmuar edhe refugjatëve shqiptarë dhe i kishte pranuar 200 shqiptarë të rrezikuar nga Kosova. Si shembull i kohëve të fundit, një i anketuar deklaroi se KOS-i kishte mbledhur donacione për të ndihmuar popullsinë në Shqipëri që ishte prekur nga tërmeti shkatërrues disa muaj më parë (Intervista nr. 9). Ceket gjithashtu se murgeshat e Kishës Katolike nga Peja po ndihmojnë në përkujdesje për të kthyerit serbë në atë qytet.

Si shembuj të rëndësishëm ceken edhe përfaqësuesit e kishës që publikisht e flasin gjuhën e një komuniteti tjetër. Në një konferencë të madhe në Lubjanë, abati i Manastirit Draganac, Iraliron, u ngrit në këmbë dhe filloi të fliste në gjuhën shqipe, duke dërguar mesazhe pajtimi. I njëjti abat shkoi mysafir në emision në gjuhën shqipe „dhe me edukatë dhe në mënyrë të civilizuar bisedon me përfaqësuesit e tjerë fetarë në Kosovë, por edhe me njerëz nga sektori joqeveritar dhe mediat”, gjë që e anketuara e konsideron si një gjest të rëndësishëm për marrëdhëniet (Intervista nr. 4).

Përfaqësuesi katolik përmend një vizitë në Kishën Ortodokse dhe lutjen me qindra pelegrinë, kushtuar mirëseardhjes së bashkëpunëtorëve të Peshkopit Teodosije dhe kohës së bukur që kishin kaluar së bashku (Intervista nr. 2).

Rikujton edhe procesin e pajtimit që ekzistonte midis Gjermanisë, Francës, Polonisë dhe Britanisë së Madhe pas Luftës së Dytë Botërore – ku ishin në pyetje dekada takimesh të përfaqësuesve fetarë dhe shkëmbime të studentëve që kishin dhënë fryte, pasi që ato përvoja përfaqësuesit fetarë i përcollën në komunitetet dhe në mjedisin e tyre. (Intervista nr. 12).

## **HESHTJA MEDIATIKE**

Disa bashkëbisedues nga sektori joqeveritar dhe ai i mediave theksojnë rëndësinë e dërgimit publikisht të mesazheve simbolike – qoftë kur përfaqësuesit e konfesioneve të krishterë dhe myslimanët ulen në të njëjtën tryezë, qoftë kur e vizitojnë njëri-tjetrin në festat e mëdha, ose kur organizojnë takime, por të gjithë me vizibilitet publik. Është e rëndësishme që ky imazh dhe ai mesazh i dialogut, i „bisedës normale”, të dalë në publik. Konsiderohet se disa prej përfaqësuesve të kishës kjo nuk do t’u shkonte për shtati, por që, kryesisht, për mungesën e imazheve të tilla si përgjegjëse shihen mediat.

Por përfundimi është se për shkak të përzgjedhjes së lajmeve në media, që shpesh bazohet në stereotipizimin “e dëshirueshëm” të të mirëve dhe të këqijve dhe në shfaqjen bardh e zi “ne” dhe “ata”, si dhe nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të elitave politike, ose për shkak të vendimeve të vet përfaqësuesve fetarë, ajo mbetet nën radar. Është e nevojshme që gazetaria profesionale, në përputhje me standardet, të japë mundësinë që serbët dhe shqiptarët të paraqiten si njerëz me probleme të përditshme, dhe jo si pjesëtarë të dy kampeve të papajtueshme, theksohet në intervista. Disa të anketuar i kritikuan mediat edhe për mungesën e zërave të caktuara, dhe, siç u përmend, për heshtjen e asaj që nuk përputhet me politikën zyrtare.

„Mediave me frekuencë kombëtare dhe atyre që përshtaten me agjendën politike të Beogradit nuk u shkon për shtati të shohin ndonjë pamje tjetër nga Kosova përveç asaj ‘serbët e mjerë dhe të këqijtë shqiptarë’. Me gjithë marrëdhëniet komplekse serbo-shqiptare, në Kosovë po zhvillohet njëfarë jete larg syve të publikut beogradas. Ekzistojnë marrëdhënie të mira në Kosovë deri në një farë mase, ndoshta jo në masë të mjaftueshme, por në hapësirën publike është e dukshme vetëm ajo që i përshtatet politikës zyrtare” (Intervista nr. 4). Bashkëbiseduesja tregon se e njëjta vlen edhe kur organizohen takimet ndër fetare, përkatësisht takimet në të cilat marrin pjesë udhëheqësit fetarë nga Kosova.

## **VETËKRITIKA SI DOMOSDOSHMËRI**

Diskursi mbizotërues publik i shumë të anketuarve që e shikojnë tablonë më të madhe dhe *klimën e përgjithshme*, përshkruhet si i pafavorshëm, e për të cilin përgjegjësia kryesore, përveç mediave, bie kryesisht mbi politikën. Të anketuarit nga radhët e kishave, por edhe ekspertët, vërejnë se është e rëndësishme të mos politizohen qëndrimet dhe të mos lejojnë që politika ta instrumentalizojë kishën. Këtë e theksojnë veçanërisht përfaqësuesit e KOS-it, dhe disa ekspertë vlerësojnë se kjo distancë nga politika është e suksesshme. Klima e përmendur karakterizohet nga akuza reciproke, bartje të fajit dhe retorikë agresive, përmbledhet në një përgjigje (Intervista nr. 7).

Në mënyrë që kishat dhe bashkësitë fetare tradicionale në Kosovë, përveç uljes së tensioneve dhe përkrahjes ndaj popullit të tyre, t'i aktualizojnë ndjeshëm potencialet e tyre për pajtim dhe normalizim, si dhe me shembullin e tyre të *zhvendosen* në mënyrë të konsiderueshme nga korniza dominuese e konfliktit, të anketuarit së pari theksojnë vetë-kritikën, përbalja me të vërtetën për të kaluarën e tyre dhe të bashkësive të tyre etnike dhe të flasin për narrativa historike kundërshtuese „për gjithçka që ka ndodhur në Kosovë në njëqind vitet e fundit”. Përgjigjet merren me shkaqet dhe pasojat dhe hapat e mundshëm praktikë për të ndihmuar në proceset e pajtimit.

„Të flasin publikisht për krimet e kryera të palës së tyre kombëtare, dhe jo vetëm të tjetrës, si dhe të mos e kushtëzojnë punën në veten e tyre, me punën e palës tjetër mbi veten e vet” (Intervista nr. 8)

„Asnjëra bashkësi etnike nuk ka treguar gatishmëri për t'i kuptuar vuajtjet e palës tjetër. Në këto rrethana, pajtimi është gati i pamundur, por ekziston një tendencë më e madhe drejt majorizimit dhe injorimit, shpesh në harresë dhe fshehje “(Intervista nr. 9).

„Mendoj se duhet të ketë takime më intensive, edhe ato të pakëndshme, në të cilat të dyja palët do të ishin me të vërtetë të gatshme që të shohin në të kaluarën e tyre dhe se rrethanat historike të mos shihen ekskluzivisht përmes prizmit të njërit ose narrativit tjetër të etabluar të konfliktit” (Intervista nr. 12).

Gjithashtu, “e vërteta” përsëritet si një fjalë kyçe – e vërteta për veten dhe të tjerët; duke e parë veten dhe të tjerët nën dritën e së vërtetës objektive; ballafaqimi me të vërtetën dhe, në fund, të vërtetën si përbalje me krime kundër civilëve të të dyja palëve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë, duke njohur vuajtjet dhe pësimet e popullatës civile, qoftë gjatë kohës së veprimeve luftarake ose në vitet pas luftës. Sigurisht, si aspekte të rëndësishme përmenden pendimi dhe falja.

Disa të anketuar i kritikuan ose paralajmëruan për qëndrimet e udhëheqësve fetarë që universalizmin e mësimit fetar e zëvendësojnë me veçantinë e kombëtares, sepse atëherë kombëtarja fitoi epërsi ndaj fetares.

„Përfaqësuesit fetarë e marrin rolin e tribunëve popullorë ose të profetëve kombëtarë, dhe ky është një fenomen i rrezikshëm që është i pranishëm në hapësirat e Ballkanit që nga vitet 1990-ta” (Intervista nr. 10).

Pasojë e këtij „largimi nga e vërteta themelore e librave të shenjtë” (Intervista nr. 3) është mungesa e dimensionit shoqëror të fesë, pra brengosja për të mirën e përbashkët, e cila do të përfshinte në mënyrë më të gjithanshme dhe me më përmbajtje dialogun ndër fetar dhe ekumenik, por edhe duke i inkurajuar për ndërveprim besimtarët e bashkësive të ndryshme fetare.

## SHËNIM

### **KONCEPTI I PËRDORSHËM TEORIK – GARA NË TË QENIT VIKTIMË**

Autoret dëshirojnë ta fusin në përdorim një term për të cilin ato konsiderojnë se nuk është përdorur mjaftueshëm dhe nuk është reflektuar në diskursin tonë lokal akademik dhe atë publik, e që mund të jap përgjigje të caktuara në lidhje me konfliktet etnike dhe konfliktet e tjera ndërmjet grupeve, e që nga korpusi i kësaj qasjeje të nxirren udhëzime të caktuara.

Kishat dhe bashkësitë fetare, si aktorë të rëndësishëm shoqërorë, në proceset e kapërcimit ose të mbajtjes së konflikteve, marrin pjesë ose mund të gjejnë mënyra për t'u përpjekur për të dalë nga spirala e të ashtuquajturës **gara në të qenit viktimë** (*competitive victimhood*), ku, në rastin konkret, edhe shqiptarët e Kosovës, e edhe serbët e Kosovës e shohin veten si „viktima të agresionit të kryer nga ai komuniteti tjetër, dhe si rezultat, armiqësia dhe mosbesimi ndëretnik janë gjithmonë të pranishëm. Në një shoqëri të vogël si Kosova, konflikti i ka prekur shumicën e banorëve direkt dhe personalisht, ndërsa këndvështrimet diametralisht të kundërta mbi të kaluarën nuk janë trajtuar kurrë në një dialog kombëtar të rrënjësor për hir të zgjidhjes së përvojave dhe perspektivave dhe me qëllimin për të shëruar shoqërinë”<sup>19</sup>.

Gara në të qenit viktimë (*Competitive victimhood*) definohet si pretendim subjektiv i secilit grup në konflikt se janë ata që kanë vuajtur më shumë se sa grupi i jashtëm (tjetër) dhe se ata kanë përjetuar më shumë padrejtësi<sup>20</sup>. Thënë thjesht, grupet garojnë për statusin e viktimës që nënkupton se ata do të shihen si të pafajshëm dhe moralisht superior. Është vërtetuar se gara në të qenit viktimë ka të bëjë me mbajtjen e konfliktit, përkatësisht vlerësimin subjektiv pozitiv të dhunës së grupit të vet dhe pamundësisë për të falur një grup të jashtëm (tjetër), si dhe për të justifikuar hakmarrjen që mund të pasojë.<sup>21</sup>

Psikologët socialë kanë arritur në përfundimin se roli i viktimës është mjet i rëndësishëm psikologjik sepse forcon kohezionin brenda grupeve, ndihmon grupin të mos pranojë përgjegjësi për veprat e këqija që ka kryer dhe kështu e shpëton atë nga emocione të pakëndshme, kërkon mbështetje morale dhe materiale nga palët që nuk janë të përfshira në konflikt drejtpërdrejt dhe e justifikon dhunën.

E gjithë kjo krijon një spirale konflikti, e mban të gjallë konfliktin edhe pasi ai të ketë mbaruar, si dhe paraqet pengesë thelbësore për pajtimin dhe normalizimin. Prandaj, duhet të dëgjohet historia e tjetrit dhe viktimat nga të dyja palët duhet të bashkohen nga përvoja e vështirësive nëpër të cilat ata kanë kaluar.

<sup>19</sup> UNDP në Kosovë dhe Akademia Folke Bernadot. (2019). Kohezioni Social në Kosovë: Shqyrtimi i kontekstit dhe pikave hyrëse, f. 12.

<sup>20</sup> Za više o konceptu, vidi Nadler, Ariel. Malloy, Thomas i Fisher, Jeffrey D. (2008). *The Social Psychology of Intergroup Reconciliation*. Oksford : Oxford University Press.

<sup>21</sup> Shnabel, Nurit; Noor, Masi; Nadler, Arie; Halabi, Samer. (2012). *When Suffering Begets Suffering: The Psychology of Competitive Victimhood Between Adversarial Groups in Violent Conflicts*. *Personality and Social Psychology Review*. 16. Str. 351– 374.

Hulumtimet tregojnë për disa aktivitete dhe veprime që mund të ndihmojnë për të dalë deri diku nga „rrethi vicioz”, për të cilin konsiderojmë se janë udhëzues të rëndësishëm për kontekstin lokal: kultivimi i identitetit të përbashkët të viktimës; të mësuarit dhe shkëmbimi i përvojave të vuajtjes (për shembull, humbja e një anëtari të familjes në konflikt); vendosjen e identiteteve të dyfishta; ndarja e përgjegjësisë (ata që ishin përgjegjës) nga vuajtjet (që ishin të përbashkëta); duke e orientuar vëmendjen në çmimin e konfliktit; duke zbardhur trashëgiminë e përbashkët të gabimeve historike dhe të dhunës; gazetari që është e orientuar kah paqja dhe jo kah përshkallëzimi i konfliktit; kontaktet ndër grupe; bisedat dhe diskutimet për ngjashmëritë ndërmjet grupeve, ngjashmëritë e problemeve të tyre aktuale.



## VËREJTJET PËRMBYLLËSE

Çështje thelbësore e veprimtarisë së përbashkët nga qeveritë, kishat dhe bashkësitë fetare sa i përket qasjes etike, politike dhe juridike ndaj pajtimit është „mënyra në të cilën do të zgjidhet çështja e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në të kaluarën” dhe „shpesh është vendimtare për aftësinë e qeverisë së re demokratike që politikisht të mbijetojë dhe ta forcojë demokracinë”<sup>22</sup>. Marrëdhënia ndërmjet politikës dhe bashkësive fetare nuk duhet të jetë raport i forcave, por marrëdhënie e aktorëve të përgjegjshëm shoqërorë, të cilët në sferat e tyre kontribuojnë për paqen në shoqëritë e tyre dhe ato fqinje, dhe të cilët përpiqen të kontribuojnë në krijimin e një kujtese kolektive që nuk i mban „plagët vazhdimisht të hapura”. Mos ballafaqimi me të kaluarën sjell aktivizimin e pamjeve dhe ngjarjeve kundërshtuese të shtypura dhe të ngrira dhe mund të çojë në kthimin e narracionit të luftës, krijimin e intolerancës dhe pengesave të reja në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, siç ka treguar historia e rajonit. Bashkësitë fetare, duke mbrojtur vlerat e tyre – faljen, pajtimin, vetë-reflektimin, barazinë – mund të ndikojnë pozitivisht në tensionet e mundshme. Natyrisht, se edhe ato do të duhet të “eksponojnë” veten e tyre, përkatësisht, t’i rishqyrtojnë veprimet dhe rolin e tyre të deritanishëm dhe me shembullin e tyre të tregojnë një model të dëshirueshëm shoqëror. Në atë mënyrë, do të parandalohej pajtimi „duke përmbushur skemën, e cila përsëri do të përfundonte në arkiva. Shumica e viktimave nuk mund të llogarisin në asgjë tjetër përveç se, në rastin më të mirë, në kompensim ekonomik”<sup>23</sup>.

Përvojat nga vendet e tjera na mësojnë se proceset e pajtimit dhe të normalizimit të konceptuar nga kishat dhe bashkësitë fetare, ose ato ku kishat dhe bashkësitë fetare janë pjesëmarrëse aktive, e përplotësojnë ndjeshëm procesin e bashkëpunimit politik dhe ekonomik. Kontributi i tyre në procesin e bashkëpunimit politik dhe pajtim mund të ketë karakter konstruktiv dhe të kontribuojë në të ardhmen paqësore të rajonit.

Vlerat dhe virtytet e një bashkësie fetare mund të “inicohen” përmes “fesë praktike”<sup>24</sup>, në mënyrë intervencioniste (përmes lutjeve, disiplinës asketike), mënyrës diskursive (me interpretime, shpjegime, me intensifikim të njohurive fetare), dhe në një mënyrë të derivuar (duke i përkthyer përmbajtjet dhe ngjarjet e përditshme në ato fetare). Pjesëmarrja e kishave dhe e bashkësive fetare në procesin e pajtimit, manifestohet përmes rrëfimit dhe lutjeve, kur artikulimi personal i së vërtetës ka efektin e çlirimit dhe të pastrimit: „dhe e gjithë fuqia e ndjenjës fetare subjektive vërtetohet përmes ndjenjës së sigurisë”<sup>25</sup>. Nga ky manifestim i tipit personal lind angazhimi shoqëror i institucioneve fetare dhe i individëve, gjithashtu me një efekt psiko-social.

<sup>22</sup> Skaar, Elin; Andreassen, Bård Anders (2000). *Obračun sa teškim kršenjima ljudskih prava na prelazu u demokratiju*, str. 17 i 21, u: Teško pomirenje, urednik Enver Đuliman, izd. Helsinški komitet Norveške, Norveška crkvena pomoć, Oslo – Sarajevo.

<sup>23</sup> Vidi u: Holtedahl, Jan Petter i Tjønneland, Elling (2000). *Južna Afrika: istina, pomirenje, pravda?*, str. 224, u: Teško pomirenje, urednik Enver Đuliman, izd. Helsinški komitet Norveške, Norveška crkvena pomoć, Oslo – Sarajevo.

<sup>24</sup> Shih: *Die Relativisierung der Religion als politische Kraft: Martin Riesebrodts Interpretation des religiösen Fundamentalismus* (2004). str. 361 (*Relativizovanje religije kao političke snage: Martin Rizebrotova interpretacija religioznog fundamentalizma*), u: „Religion und Gesellschaft“, izd. Karl Gabriel i Hans-Richard Reute, Schöningh UTB 2150. (lični prevod A. Popović).

<sup>25</sup> Po aty, f. 91.

Kisha, si aktor i përgjegjshëm shoqëror, mund të ndihmojë në vendosjen e paqes ndërmjet individëve dhe shoqërive, në të kaluarën, duke i futur ata në paradhomën e një të ardhmeje paqësore.

Konsiderojmë se në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, pavarësisht niveleve politike dhe ekonomike të bashkëpunimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, plani i madh i agjendës rajonale të „konektivitetit” duhet të plotësohet me pjesëmarrjen e kishave dhe të bashkësive fetare në lidhjen e njerëzve (*lidhja e njerëzve – dimension social*, procesi i Berlinit). Paktimi në këtë nivel, do të kontribuojë në formësimin e paktimit në nivele të tjera, të cilat vlerësohen për nga metodat dhe masat ligjore dhe sasiore (drejtësia transicionale, ballafaqimi me të kaluarën, lustracioni, gjykatat dhe institucionet ndërkombëtare, konventat, komisionet e së vërtetës dhe të paktimit, e të tjera të ngjashme).

## **REKOMANDIMET**

### **Rekomandimet për kishat dhe bashkësitë fetare**

- Takime më të shpeshta të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme fetare, si atyre nga Kosova, ashtu edhe atyre nga Serbia;
- Organizimi i takimeve ndër fetare për çështje komplekse dhe të ndjeshme, rezultatet e të cilave përkatësisht bisedat, do të ishin të disponueshme për publikun;
- Shfrytëzoni takimet e udhëheqësve fetarë me njëri-tjetrin, si dhe takimet e udhëheqësve fetarë me aktorë të tjerë shoqërorë, për të edukuar dhe informuar brezat e rinj për rëndësinë e marrëdhënieve të mira ndër fetare;
- Kishat dhe bashkësitë fetare duhet t'i rishqyrtojnë rolin dhe veprimet e tyre të gabuara në të kaluarën, në mënyrë që kësaj të japin shembull në publik;
- Inkurajoni bashkëveprim më të madh të besimtarëve dhe shkëmbimin e përvojave të tyre, ashtu që të kërkohen pika takuese të përbashkëta, si në fushën e fesë, ashtu edhe në jetën e përditshme, në përvojën e pikëllimit, të humbjes;
- Forcimi i solidaritetit midis Kishave dhe bashkësive fetare. Reagoni me zë më të lartë në publik në rastet e incidenteve që rrezikojnë bashkësinë tjetër fetare, kjo vlen edhe për aktorët shoqërorë;
- Kur të përmbushen kushtet për pajtim, Kishat dhe bashkësitë fetare mund të iniciojnë ose marrin pjesë në punën e komisioneve për t'u marrë me viktimat dhe vuajtjet e të gjithë qytetarëve, dhe duke i mbështetur viktimat, do t'u ndihmonim atyre që ta kapërcejnë traumën ose të inkurajojnë pendimin e kriminelëve;
- Konceptimi i një „edukimi për paqen” që të jetë funksional, i bazuar në vlerat universale fetare dhe përmbajtjen faktike historiografike;
- Filloni një bisedë ndërmjet kishave dhe bashkësive fetare në lidhje me narrativat kundërshtuese historike;
- Në institucionet arsimore-fetare ekzistuese, punoni në temat si pajtimi shoqëror, shërimi, transformimi i konflikteve.

### **Rekomandimet për mediat**

- Edukoni mediat që t'u kushtojnë më shumë vëmendje ngjarjeve të mira dhe konstruktive, si dhe në përputhje me standardet e gazetarisë, të publikojnë tekste në të cilat do të jenë të pranishëm „më shumë zëra”;
- Individëve nga kishat që tashmë janë modele dhe role, t'u jepet më shumë vëmendje mediatike.

### **Rekomandimet për organizatat ndërkombëtare dhe sektorin civil**

- Organizoni takime më intensive të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme fetare nga Serbia dhe Kosova, si dhe përfshini përfaqësuesit e kishave dhe të bashkësive fetare në projekte të rëndësishme për shoqërinë;

- Shfrytëzohen bashkëpunimin e mirë ekzistues ndërmjet bashkësive fetare për dialogun track-III, veçanërisht në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura;
- Mbani kurse, programe dhe shkolla për këto çështje, ku duhet të përfshihen përfaqësuesit e kishave;
- Mbështetje financiare për projekte dhe iniciativa nga organizata ndërkombëtare ku do të përfshiheshin kishat dhe bashkësitë fetare si aktorë kryesorë, ose programe që kanë për synim edukimin e personelit fetar;
- Ofroni më shumë mbështetje për individët e shquar nga kishat dhe bashkësitë fetare në zbatimin e projekteve të tyre.

## **E bashkëngjitur 1: Lista e intervistave**

Intervista 1, përfaqësues i KOS-it, Dioqeza e Rashkës – Prizrenit

Intervista 2, përfaqësues i lartë i Kishës Katolike në Kosovë, Ipeshkëvia Prizren – Prishtinë

Intervista 3, përfaqësues i Kishës Katolike në Serbi, Ipeshkëvia e Suboticës

Intervista 4, gazetar, Kosovë

Intervista 5, profesor, Kosovë

Intervista 6, përfaqësues i bashkësisë ndërkombëtare, Kosovë

Intervista 7, gazetar, Serbi

Intervista 8, profesor, Gjermani

Intervista 9, përfaqësues i sektorit joqeveritar, veri i Kosovës

Intervista 10, profesor, Suedi

Intervista 11, përfaqësues i Kishës Katolike në Serbi, Arqipeshkëvia e Beogradit

Intervista 12, teolog, KOS

Intervista 13, përfaqësues i Kishës Katolike në Serbi, Arqipeshkëvia e Beogradit

Intervista 14, përfaqësues i KOS-it, Kryepeshkopata e Beogradit dhe e Karlovacit

Intervista 15, teolog, KOS



KONVENTA KOMBËTARE RRETH  
BASHKIMIT EVROPIAN  
KNEZA MILOŠA 4  
11000 BEOGRADI  
[WWW.EUKONVENT.ORG](http://WWW.EUKONVENT.ORG)  
[OFFICE@EUKONVENT.ORG](mailto:OFFICE@EUKONVENT.ORG)



INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN  
EKONOMIK TERRITORIAL (INTER)  
VLJKOVIĆEVA 29  
11000 BEOGRADI  
+381 (0)11 3246 766  
[WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG](http://WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG)  
[OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG](mailto:OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG)